



## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

### KARTË - TEKNOLOGJIKE

#### **Mbi sëmundjen e tharjes së shpejte të ullirit (*Xylella fastidiosa*).**

Kjo sëmundje është zbuluar në provincën e Leçes- Apulia - Itali në muajin Tetor të vitit 2013. Në të gjithë rajonin e Puljes ka prekur rreth 8000 Ha të mbjella me ulli.

Sëmundja prek hardhinë, pemët frutore, ullirin, agrumet e ëmbla, drurë pyjorë, perime, lule dielli, bime dekorative etj.

Transmetohet nga një bimë tek tjetra nga afidet të cilat kanë aparat shpus - thithës ose pleshtat siç është Pleshti jeshil (*Graphocephala Atropunctata*). Këto insekte fluturojnë deri në 100 m largësi, por mund të shpërndahen më tej nga era, duke realizuar kështu infektive në bimë të tjera. Shpërndarja e kësaj sëmundje mund të bëhet edhe nëpërmjet lëvizjes së materialit mbjellës të infektuar ose edhe nëpërmjet tregëtimit të frutave.

Simptomat e shkaktuara nga *Xylella Fastidiosa*, u vrojtuan fillimisht me 1892 në një rajon të kultivimit të hardhisë në Kaliforninë Jugore (SHBA), dhe kjo sindromë u quajt 'Pierce's disease'. Në vazhdim, sëmundje të ngjajshme u raportuan mbi shumë drufrutore dhe specie ornamentale, si phony peach në pjeshkë, xhuxhëzimi i jonxhës, vyshkja e Vincia, kloroza me lara në agrume, përzhitja e gjetheve në kumbull, panjë, dardhë, bajame, vidh, man, pemë gjethegjëra hijezuese, lis, oleandër dhe kafe, veçanërisht në Amerikën e Veriut dhe të Jugut (Hopkins, 1989). Në Europë, sëmundja është raportuar në mënyrë të dyshimtë një herë mbi hardhi në rajonin e Kosovës. Në shumicën e bimëve strehuese patogjeni shkakton vyshkje në gjethe, tharje të degëzave, dhe dobësim të bimës.

*X. Fastidiosa*, shumohet në gypat e ksilemës. Transmetimi natyral ndodh nëpërmjet insekteve që ushqehen duke thithur lëngjet në ksilemë. Efiçienca e transmetimit ndryshon gjerësisht midis specieve vektore. Bakteri mbijeton në ksilemën e bimës strehuese, si dhe në barishtet konkurruese. Prej këtyre të fundit, ai transmetohet tek bimët strehuese në pranverë.

#### **Identiteti:**

Emri: *Xylella fastidiosa* Wells et al. (1987)

Pozicioni taksonomic: Bacteria, Gracilicutes, shkopi nj Gram-negativë aerobice, Kategoria I, Grupi 4, Nëngrupi 4 A (Holt, 1994)

Kodi kompjuterik Bayer: XYLEFA

Kategorizimi fitosanitar: Lista A1 EPPO nr. 137 & 166; Përfshihet në Aneksin I /A1 të BE *Xylella fastidiosa* mbi hardhi, peach phony rickettsia mbi pjeshkë dhe kloroza me lara mbi

agrumë. Në vitin 2013, patogjeni u njoftua të jetë present në ulli në Italinë e Jugut.

### **Zbulimi:**

#### **Simptomat e sëmundjes:**

Inspektimi i kulturave që dyshohen të jenë infektuar nga *X. Fastidiosa*, është bazë për zbulimin e simptomave të hershme të infeksionit. Ka një fluks sezonal në zbulimin e individëve të infektuar. Në agrumë, përfitimi më i mirë i patogjenit nga rrënjët dhe kërcenjtë bëhet në dy periudha: në mes të verës muajt (Qershor-Gusht) dhe në mes të dimrit muajt (Dhjetor-Shkurt). Në hardhi, periudha më e mirë për zbulim është vonë në vjeshtë dhe në fillim të vjeshtës. Në ulli periudha më e përshtatshme mund të jenë muajt Qershor-Shtator.

**Në ulli**, është njoftuar shfaqja e sëmundjes në Italinë e Jugut; bimët e prekura të ullirit paraqesin vyshkje dhe tharje në degë të veçanta të kurorës, më vonë mund shtrihen në degët skeletike ose në të gjithë kurorën. Në brendësi të degëve të rendeve të ndryshme, si në lastarë, degët kryesor, etj., dallohen nxirje të indeve të drurit. Në gjethet e lastarëve të prekur vërehen gjethe me njolla nekrotike, kryesisht në zonën e majës ose në ato anësore. Nga kërkimet e deritanishme në Itali, fenomeni është mbiquajtur “Kompleksi i tharjes së shpejtë të ullirit”, për arsye të bashkëshoqërimit të mundshëm të bakterit *Xylella Fastidiosa*, dhe disa kërpudhave parasite të sistemit përcjellës të drurit, pjestarë të gjinive *Phaeoacremonium* e *Phaemoniella*, si dhe lepidopterit (*Zeuzera Pyrina*).

**Mbi hardhi**, simptoma kryesore e infeksionit primar është përcëllimi i gjethes. Një shenjë e hershme e sëmundjes është tharja e menjëhershme e një pjese të llapës së gjethes, e cila merr ngjyrë kafe dhe shumë shpesh është e rrethuar nga një brez indesh me ngjyrë të zverdhur ose të përskuqur. Më pas, vyshkja përhapet dhe gjethja vyshket dhe bie, ndërkohë që bishti i gjethes mbetet i ngjitur mbi lastar. Vyshkja e degëzës zakonisht fillon nga maja. Degët e infektuara piqen në mënyrë të ç’rregullt duke paraqitur zona me inde të gjelbra. Bimët e prekura në pranverë çelin më vonë se sa të shëndoshat. Ato të prekura rëndë mund të thahen brenda 1-2 vjetësh. Simptomat rrallë se mund të zbulohen në bimët 1-vjeçare. Simptomat mbi degë mund të ngatërrohen me ato të shkaktuara nga kërpudhat fitopatogjene si (*Eutypa Lata*) dhe (*Phomopsis Viticola*).

**Në agrumë**, simptomat janë më të dukshme në pemët 3-6 vjeçare dhe kryesisht në kultivarë të portokallit të ëmbël. Në pemët e prekura vërehen gjethe me njolla të verdha klorotike duke kujtuar për mungesë zingu, pjesa e poshtme e gjethes paraqet njolla nekrotike ngjyrë kafe lehtësisht të ngritura. Frutat janë shumë më të vegjël se normalet dhe shumë të fortë. Lulja dhe fruti formohen në të njëjtën kohë si në bimët e shëndosha, por tek ato të prekurat mbeten të vegjël dhe piqen më herët. Shpejtësia e rritjes e pemëve të prekura, është dukshëm më e reduktuar dhe degëzat dhe degët kryesore mund të vyshken. Zakonisht bimët nuk thahen, po ashtu edhe në rrënjë nuk shfaqen simptoma të dukshme.

**Në pjeshkë**, lastarët e rinj duken më të shkurtuar dhe me një vegjetim më të dëndur dhe më të gjelbëruar se sa bimët e shëndosha. Degët anësore zhvillohen horizontalisht ose me drejtim për poshtë, kështu që pema duket uniforme, kompakte dhe me formë rrethore. Gjethet dhe lulet

shfaqen herët dhe gjethet mbeten mbi pemë më gjatë se ato mbi pemët e shëndosha. Në pemët e prekura prodhimi bie në mënyrë të theksuar duke dhënë fruta më të vegjël dhe pas 3-5 vitesh ato bëhen ekonomikisht pa përfitim.

#### **Identifikimi Izolimi:**

*Xylella Fastidiosa*, është e vështirë të izolohet dhe të rritet në kulturë të pastër. Patogjeni nuk rritet në shumicën e terreneve ushqyes të zakonshëm për bakteret.

**Nuk ekziston asnjë strategji për luftimin e kësaj sëmundje, prandaj mënyra e vetme për parandalimin dhe përhapjen e saj janë dy:**

**- Kontrolli fitosanitar i materialit mbjellës dhe frutave që importohen nga jashtë**

**- Kontrolli i insekteve transmetues të *Xylella Fastidiosa*.**

#### **Situata në vëndin tonë.**

Nga monitorimet e bëra gjatë muajit Dhjetor 2013 - Janar 2014 në rajonin e Vlorës, nisur nga shqetësimet e ullishtarëve është konstatuar se kjo sëmundje është prezente në ullishtet tona. Në bimët e ullrit janë vërejtur tharje të lastarëve në një gjatësi 30-40 cm, të shpërdara në të gjithë kurorën. Fillimisht u gjykua për prekje nga sëmundja (*Verticillium Dahliae* Kleb.), por dyshimet u hodhën për një sëmundje të panjohur nga ana jonë. Nga informacionet e marra si dhe pamjet e bimëve të prekura në Pulja, mendojmë se kemi të bëjmë me të njëjtën sëmundje. Deri tani prekje kemi konstatuar në zonën e Shamogjinit, Skrofotinës, Cerkovinës, Hoshtimes dhe Panajasë, Xarrë-Sarandë në sipërfaqe të kufizuara. Mundësia e përhapjes në këtë zonë është e lidhur me sipërfaqet e mëdha të vreshtave ku është prezent edhe vektori i saj (*Pleshti Jeshil*), i cili preferon hardhinë si bimë strehuese.

Nisur nga shqetësimet që ka shkaktuar kjo trakeobakterizë në Itali-Leçe, mendojmë se duhet programuar puna për: monitorimin e saj dhe të vektoreve, kontrollin e vektorëve, kontrollin në pikat e hyrjes të materialit mbjellës dhe frutave për tregëtim. Ngritja e një grupi pune mendojmë se është hapi i parë i cili do të organizojë të gjithë sistemin e monitorimit dhe kontrollit të sëmundjes dhe veçanërisht vektorëve të kësaj sëmundje.

Specialist i Mbrojtjes së Bimëve:

Agr. Mendim Baçaj